

Politikat e investimit të aseteve

Punoi : Junida Zavalani

Miratoi : Naim HASA

Pergj. Dep. Finances

Drejtor I Përgjithshëm

Përmbajtja

POLITIKAT E INVESTIMIT TE ASETEVE

1. Përmbledhje e politikave të rëndësishme Të INVESTIMIT TË ASETEVE
2. Klasifikimi i mbajtjes së asetëve financiare :.....
 - Mjete monetare,
 - Depozita me afat
 - Tituj Qeveritare (obligacione)
3. Të rehat për vitin

1. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME TË INVESTIMIT TË ASETEVE

a) Bazat e përgatitjes

Politikat e brendshme të Shoqërisë në lidhje me investimin e aseteve të saj janë përgatitur në përputhje të ligjit Nr. 10197, datë 10.12.2009 "Per Pensionet Private" në Shqipëri. Këto politika duhen aplikuar dhe përmirësuar në vazhdimësi në të gjitha periudhat e zhvillimit të veprimtarisë duke siguruar likuiditetin e duhur në mbulim të detyrimeve/pegjegjësi si dhe kthimin maksimal nga investimi i tyre.

Aktualisht pjesa më e madhe e aktiveve të Shoqërisë përbëhet nga investime financiare krahasuar me investimet në aktive të paluajtshme, kështu që fokusimi në vijim do të jetë në politikat e investimit të aseteve financiare.

b) Monedha funksionale dhe raportuese në raportet e Shoqërisë

Shoqëria operon vetëm në monedhën Lek dhe investon vetëm në këto monedhe kjo për shkak të rrishtit nga luhajtjet e kursit të këmbimit për monedhat e huaja.

Shoqëria i menaxhon aktivet duke përdorur një mënyrë që balancon cilësinë, diversifikimin, përputhjen aktive-detyrim, likuiditetin dhe të ardhurat nga investimet. Qëllimi i procesit të investimit është që të optimizojë të ardhurat nga investimi ndërkohë që siguron që aktivet dhe detyrimet janë menaxhuar në bazë të fluksit të parave dhe zgjatjes së tyre.

Natyra e rrezikut të sigurimit, maturimi i tyre dhe struktura e monedhës së vendosur për të shprehur detyrimin kanë një ndikim tek strategjia e investimit të Shoqërisë.

Shoqëria ka një ekspozim minimal ndaj rrezikut valutës sepse aktivet financiare investohen vetëm në LEK.

Raportet financiare paraqiten në LEK shqipëtar ("LEK"), e cila është monedha funksionale e shoqërisë. Në përputhje me standartet Nderkombëtare dhe Ligjin për mbajtjen e Kontabilitetit monedha funksionale e shoqërisë është monedha e mjedisit primar ekonomik në të cilin vepron.

MJETE MONETARE, DEPOZITA ME AFAT DHE TITUJ QEVERTARE (OBLIGACIONE)

2.1. Mjetet monetare

Mjetet monetare dhe ekuivalentë me to përfshijnë: mjetet monetare të depozituara në Banken Depozitare, dhe investime afatshkurtra me likuiditet të lartë dhe me maturitet deri në tre muaj ose më pak që nga momenti i blerjes.

Qëllimi i mbajtjes së aseteve në mjete monetare është në sasinë e nevojshme për të përmbushur detyrimet imediate që mund të lindin nga detyrimet ndaj palëve të treta.

Të gjitha transaksionet financiare nga Shoqëria kryhen vetem nëpërmjet bankave

2.2. Depozitat me afat

Investimet në depozita me afat me maturitet më pak se tre muaj klasifikohen si ekuivalentë të mjeteve monetare, ato me maturitet më shumë se tre muaj klasifikohen si investime në depozita me afat. Interesi llogaritet në bazë rrjedhëse dhe interesi i arkëtueshëm pasqyrohet në llogaritë e tjera të arkëtueshme.

Investimi i aseteve në depozita me afat do të bëhet pranë Bankave të Nivelit të Dytë kryesisht në banken Depozitare ose nëpërmjet Bankes Depozitare duke synuar një normë kthimi sa më të lartë nga investimi i tyre .

Perpara se të investohen Fondet e lira pranë Bankës përkatëse Departamenti i Finances duhet të kontaktoje banka dhe të marrë një normë interesi preferenciale e cila do t'i paraqitet Drejtorit të Përgjithshëm të Shoqërisë si dhe Komitetit të investimit bashkë me opsionet e mundshme për investim.

Pasi të bëhet shqyrtimi /analiza e plotë me aprovimin e Drejtorit të Përgjithshëm dhe të Komitetit të Investimit vijohet me përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm deri në nënshkrimin e kontratës në përputhje dhe me rregullat e bankës .

Investimi depozitave të lira duhet të bëhet në përputhje me u citua më lart.

Fondi i Garancisë së Shoqërisë është investuar në depozita me afat mbi një vit si dhe në obligacione duke ruajtur kufirin 15,625,000 Lekë sipas nenit 21, ” **Kërkesat për mjaftueshmërinë**

Politikat dhe kuadri i investimeve të aseteve financiare

e kapitalit të shoqërisë administruese” te ligjitnr. 10197, date 10.12.2009 “PËR FONDET E PENSIONIT VULLNETAR”.

Ndryshimi i përbërjes së fondit të garancisë asnjëherë nuk duhet të bëhet pa marrë paraprakisht aprovimin e AMF-së dhe nuk mund të preket pa miratimin paraprak të Autoritetit.

2.3. Investimi në tituj qeveritarë (obligacione)

Titujt qeveritarë janë investime borxhi të cilat emetohen nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë e përfaqësuar nga Ministria e Financave, Shoqëria këto investime ka për qëllim dhe aftësi t'i mbajë deri në maturim dhe janë klasifikuar si aktive të mbajtura deri në maturim, investimet të cilat kanë pagesa fikse dhe të përcaktuara.

Per vitin 2018 Shoqëria do të synojë për të investuar një pjesë të aseteve financiare në obligacione afatgjata, ato janë investuar në monedhën lekë si dhe me afat nga 5 deri 10 vjeçare si bankë kujdestare për këto investime është ABI BANK.

Me shpalljen e kalendarit vjetor nga Ministria e Financave për Titujt Qeveritar te hartohet një grafik paraprak në lidhje me pjesmarrjen në ankandet që do të zhvillohen.

Pjesmarrja në ankand është me interes fiks, çfarë kërkon një analizë të ankandëve të mëparshme për të parë tendencën e kuponit apo të yield –it që do të merret pjesë.

Vet natyra e këtyre investimeve që klasifikohen me risk të ulët dhe realizimin e një norme kthimi më të lartë se depozitat i ka bërë këto investime më atraktive në investimin e fondeve të lira çfarë ka sjellë dhe rritjen e tyre nga viti në vit duke ruajtur diversifikimin e investimeve në asetet financiare.

3. Te reja per vitin

Gjate viti 2018 instrumentet e investimit te perdorura jane perqendruar ne Obligacione 7 dhe 10 vjecare, nderkohe qe drejt fundit te vitit dhe ne fillim te vitit 2019 ato do vazhdojne te investohen drejt investimeve me afatgjate.

Duke shqyrtuar brenda një viti kalendarik për periudhën Janar 2018 – Dhjetor 2018 vihet re se 100% e aseteve është përqendruar në investime afatgjata nga të cilat përfitohen edhe norma me të larta interesi. Kjo tendencë në rritje të investimeve afatshkurtra në Bono Thesari, ka ardhur duke patur parasysh edhe parimin e maksimizimit të fitimit të realizuar nga investimet e aseteve.

Kjo tendence do të vijojë edhe në investimet e ardhshme, gjithmone duke ruajtur një raport për të qenë i investuar i gjithë fondi që akumulohet duke pasur sasinë e fondeve të lira që nevojiten për pagesa immediate.

Për të akumuluar interes nga fondet që grumbullohen gjatë kohës që pritet ankandit i radhës në obligacione afatgjata propozohet që këto fonde të lihen me interes pa afat (kështu merret një fitim sado i vogël nga këto fonde) në Bankën Depozitare duke negociuar për një normë sa më të lartë interesi.

Politikat e investimit do të jenë në përputhje me rregullat dhe brenda kuadrit ligjor vendas për të siguruar një normë kthimi të sigurtë dhe sa më të lartë , duke ruajtur normat e kërkuar të likuiditetit për të siguruar likuidimin në kohë të detyrimeve ndaj palëve të treta dhe vijimësinë e aktivitetit të Shoqërisë.